



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA  
SKENDERAJ

Nr. 12-400/01-000 9944/26  
Data 18. 03. 2026



**Komuna e Skenderajt**  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm**  
Direkcija za Ekonomski Razvoj Preduzetništvo Inovacije i Turizam  
Directorate for Economic Development Entrepreneurship Innovation and Tourism

<b>DATE/A:</b>	18.03.2026
<b>REFERENC-Ë:</b>	///
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Bizneset e Komunës së Skenderajt
<b>CC:</b>	Zyrës së Kryetarit të Komunës së Skenderajt, Z. Sami Lushtaku
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm Besarta Meha Ademi
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Thirrje për Aplikim

**THIRRJE PER APLIKIM**

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, i cili përcakton kompetencat vetanake të komunës në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, si dhe në bazë të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, që rregullon menaxhimin dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore të komunës, Bazuar në rregulloren komunale për ndarjen e subvencioneve nr. 01-400/01-005/689/20 të datës 04-12-2020, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm (DZHENIT) në Komunën e Skenderajt, në kuader të programit "Participimi tek Ndërmarrjet mikro (0-9 punëtor) dhe Start Up" shpallë konkurs për mbështetje financiare.

**Objektivi i Programit**

**Mbështetje për bizneset mikro tashmë të regjistruara** që kanë filluar aktivitetin dhe tani synojnë të zgjerohen.

**Mbështetje personave fizik me ide të qartë për krijimin dhe zhvillimin e biznesit** dhe qëndrueshmërisë në treg, si dhe përmirësimi i cilësisë dhe krijimi i mundësive për vende të reja pune.

**Shuma e përfituar:** Vlera maksimale e projekt propozimit është 2 500.00 € dhe varet prej idesë së biznesit, prej numrit të të punësuarve, veprimtarisë dhe vizitës në terren. Vlerësimi i dokumentacionit dhe i biznesit të aplikueseve për grante, bëhet nga Komisioni Vlerësues.

## Kriteret për Aplikim

Përfituesit duhet të ofrojnë një **bashkëfinancim prej 20%**.

**Përparësi do t'i jepet** aplikantëve që nuk kanë përfituar në 3 vitet e fundit, nën moshën 35 vjeç, nga grupet si gratë, personat me aftësi të kufizuara, dhe ata nga zonat rurale.

Të jenë biznese që operojnë në komunën e Skenderajt (e obligueshme).

Në rast se është start up, regjistrimi i biznesit bëhet pas nënshkrimit të kontratës për dhënjën e grantit.

## Kriteret jo kualifikuese

Biznesi nuk kualifikohet nëse:

- Paraqet veti diskriminuese apo ka ndikim negativ në shoqëri dhe komunitet
- I shkakton dëme ambientit apo ndonjë grupi tjetër të marginalizuar
- Ka orientime apo qëllime politike
- Kërkon mjete për të blerë tokën për ndërtim të objektit
- Merret vetëm me tregtimin e produkteve
- OJQ-te nuk kanë të drejtë të aplikojnë
- Ka bërë ndryshim në biznes pas datës së shpalljes publike për Aplikim.

## Dokumentet për aplikim

**Bizneset Ekzistuese:**

- Aplikacioni i plotësuar
- Çertifikata e biznesit(kopje)
- Kopje e leternjoftimit të pronarit të biznesit
- Vertetimin nga ATK që nuk ka obligime (borgje)
- Vërtetimin që nuk keni obligime komunale (borxhe) në taksën në biznes dhe tatimin në pronë.
- Vertetimin nga Gjykata se nuk ka ndonjë ndalesë për zhvillimin e veprimtarisë afariste

**Start-up bizneset:**

- Aplikacioni i plotësuar
- Kopja e leternjoftimit

## Detaje të tjera

Vlerësimi do të bëhet për çdo aplikacion dhe ato më të vlerësuarat do të mbështeten me mjete dhe pajisje.

Mbështetje dhe mentorim do të ofrohet pas aprovimit për zhvillim të biznesit.

## **Aktivitetet e Pranueshme të Biznesit**

Aktivitetet që mund të mbështeten në kuadër të këtij programi janë që përfshijnë sektorë si:

- Turizëm
- Prodhues
- Perpunues
- Sherbyese që gjenerojnë punësim
- Grave, të rinjëve (nën moshën 35 vjeqare)
- Veprimtari artizanale
- Bizneset e personave me nevoja të veçanta

## **Pako Mbështetjeje**

Pako mbështetjeje do të përfshijë mjete dhe pajisje specifike për zgjerimin e aktiviteteve në sektorët përkatës.

## **Si të Aplikoni**

Aplikantët nga Komuna e Skenderajt mund të aplikojnë përmes arkives komunale, duke dërguar formularin e së bashku me dokumentet mbështetëse, në një pliko të mbyllur në adresë të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Ndermarrësi Inovacion dhe Turizëm.

Për pyetje dhe sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni zyren nr. 8 & 11 kati i parë, Komuna e Skenderaj. Pranohen vetëm aplikacionet e kompletuara dhe të plotësuara me kompjuter.

**Afati i aplikimit është nga datë e shpalljes e deri më 03 prill 2026.**